



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 4.4.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Engin Beyoglu, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE-së dhe të INPO-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;
2. Propozimrregullorja për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimrregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në komunën e Prishtinës;
4. Propozimstatuti i Arkivit të Komunës së Prishtinës;
5. Propozimstatuti i bibliotekës komunale “Hivzi Sylejmani” Prishtinë;
6. Propozimstatuti i teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”;
7. Propozimvendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës;
8. Propozimvendimi për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK “Hortikultura” SHA në Prishtinë;
9. Të ndryshme.

Pika e parë

Njësëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimrregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës, Agim Salihu tha se kjo rregullore ka të bëjë me rininë dhe është hartuar në harmoni me ligjin përkatës.

U konstatua se njëjëri u përkrähë Propozimrregullorja për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor të Komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Për Propozimrregulloren për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në komunën e Prishtinës, Agim Salihu tha se kjo rregullore është hartuar në pajtim me Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe të dispozitave të Udhëzimit administrativ për punën vullnetarë të të rinjve, dhe propozohet që të procedohet më tej.

Tefik Mehmeti bëri vërejtje në nenin 16, dhe propozoi që të hiqet pika katër (4) e këtij neni.

Me propozimin e dhënë, u konstatua se njëjëri u përkrähë Propozimrregullorja për promovimin dhe fuqizimin e vullnetarizmit në Komunën e Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimstatutin e Arkivit të Komunës së Prishtinës, Agim Salihu tha se, si obligim që kemi për Ligjin e ri për arkivat shtetërore, është propozuar që të bëhen disa ndryshime dhe plotësime në këtë statut. Lidhur me këtë, paraqiti edhe kërkesën e punonjësvë të Arkivit që kanë dhënë disa vërejtje, konkretisht rreth emërimit të këtij institucioni.

Aziz Pacolli parashtrroi pyetjen për të tre propozimstatutet, duke cekur se ku qëndron dallimi mes statutit të përparshëm dhe statutit të tanishëm.

Mustafë Krasniqi pati dy sugjerime. Në nenin tre (3), propozoi që të shtohet edhe një pikë, që pika dy (2) të jetë "Arkivi Komunal është themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës, të dt. 21.1.1969, ndërsa në pikën tre (3) në vend të fjalës "themeluar", të jetë "rithemeluar". Në nenin shtatë (7) propozoi që të fshihet pika "g".

Shefqet Sylejmani sugjeroi që titulli i këtij institucioni të jetë: “Statuti i Arkivit Komunal të Prishtinës”.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, sqarime shtesë dha **Agim Salihu**. **Kryesuesi** tha se duke pasur parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, konkretisht rreth emërimit, grupet parlamentare presin një interpretim, rekomandim nga grupet punuese që kanë hartuar këto propozimstatute.

Me plotësime dhe ndryshime, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimstatuti i Arkivit të Komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimstatutin e bibliotekës komunale “Hivzi Sylejmani” Prishtinë, Agim Salihu tha se ky propozim është harmonizuar me Ligjin për bibliotekat, i cili është në fuqi.

Milazim Vitija tha se më herët kjo bibliotekë ka qenë ndërkomunale, andaj pyes se tani do të jetë bibliotekë komunale, apo ndërkomunale.

Tefik Mehmeti bëri vërejtje në nenin dymbëdhjetë (12), pika një (1), dhe propozoi që në vend të fjalës “bibliotekës” të jetë “bibliotekarisë”. Lidhur me nenin trembëdhjetë (13), tha se pika katër (4) e këtij neni duhet të përmirësohet dhe të jetë “kolegjiumi profesional”.

Shefqet Sylejmani vërejtje bëri në nenin tre (3), pika 3, ku propozoi që pas fjalëve “ka miratuar Vendimin”, ti shtohet „ për vazhdimin e punës së bibliotekës komunale.....”

Me plotësime dhe ndryshime, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimstatuti për bibliotekën komunale “Hivzi Sylejmani” Prishtinë, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Për Propozimstatutin e teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona” informoi Agim Salihu, gjegjësisht rreth disa neneve që kanë të bëjnë me xhirollogarinë, emërimin e drejtorit etj.

Mustafë Krasniqi propozoi që në nenin shtatë (7), pikat **a** dhe **b** të riformulohen në një pikë, ndërsa si pikë e veçantë të shtohet: Organizimi i festivaleve.

Tefik Mehmeti propozoi që pika 3 e nenit 3, të plotësohet dhe pas fjalëve “ka miratuar Vendimin” të jetë: “për vazhdimin e punës së teatrit të qytetit”.

Shefqet Sylejmani sugjeroi që të mendohet se si të jetë emërtimi i këtij institucioni, a do të jetë “Teatri i qytetit të Prishtinës “Dodona””, apo: “Teatri “Dodona” i qytetit të Prishtinës”.

Kryesuesi kërkoi nga Zyra ligjore që të konsultohet Ligji për teatrot, dhe të shihet se si e përkufizon emërtimin e këtij institucioni.

Me ndryshime dhe plotësime, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimstatuti i teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona” dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës, Agim Salihu tha se është vendimi i dytë që ka të bëjë me shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve që janë të vendosura në zonën industriale.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK “Hortikultura” SHA në Prishtinë, Agim Salihu tha se është propozuar që kësaj ndërmarrje t’i jepet një lokacion për kultivimin e fidanëve dhe luleve.

Shemsi Veseli propozoi që në nenin gjashtë (6) të këtij propozimvendimi, që ka të bëjë me kushtet e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm, të specifikohen me marrëveshje të veçantë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e lokacionit në shfrytëzim të përkohshëm NPK “Hortikultura” SHA në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Aziz Pacolli ngriti çështjen e mos realizimit të disa projekteve të infrastrukturës, duke thënë se për vitin 2012 në projekt kanë qenë pesë rrugë për t’u rregulluar në fshatin Marec. Njëra prej rrugëve me prioritet ishte edhe rruga Qukë - Flatacion. Për mos realizimin e këtyre projekteve të rrugëve, ai kërkoi arsyen e heqjes së tyre.

Milazim Vitija tha se kryetarët e bashkësive lokale i kanë dërguar prioritetet për vitin 2012, dhe për këtë vit shihet se për realizim është vetëm rruga Slivovë - Golimivadë.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga Aziz Pacolli dhe Milazim Vitija, rreth realizimit të projekteve për rrugët në zonat rurale, **kryesuesi** dha sqarime shtesë.

Shëfqet Sylejmani ngriti shqetësim për mos kthimin e përgjigjeve për shumë çështje, të cilat janë shtruar për drejtoritë përkatëse. Njëra prej kërkesave ishte edhe ajo për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, duke shtuar se vija e premtuar për transportin e udhëtareve nga lagja "Kodra e Diellit" - Ministria e Arsimit - Gërmi, deri më tani nuk është realizuar.

Për Drejtorinë e Inspeksionit shumë herë është shtruar pyetje për kërkesën që hapësira para Gjykatës së qarkut të lirohet nga automjetet e ndryshme të parkuara dhe nga punëtorët e krahut, të cilët janë bërë pengesë edhe për qytetarët që banojnë aty edhe për kalimtarët.

Gjithashtu kërkesa për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që ka të bëjë me ndarjen fizike të pronës në kompleksin "Dielli", duke kërkuar që anëtari i Komisionit, z. Behxhet Musliu, i caktuar nga Kryetari i Komunës, ta finalizojë punën lidhur me ndarjen e pronës që i takon Komunës nga pjesa e pronës së investitorit - ndërmarrjes "Stan-Glob", që ishte koncesionar në ndërtimin e kompleksit banesor "Dielli", në lagjen "Kodra e Diellit".

Për shqetësimet e ngritura nga z. Sylejmani, **kryesuesi** tha se kërkesat e ngritura janë çështje të ekzekutivit.

Mustafë Krasniqi kërkoi që hapësirës para Gjykatës së qarkut t'i bëhet një tretman, të bëhet pjesë e gjelbëruar.

Hazir Boroci e falënderoi kryesuesin dhe shefin e Zyrës ligjore që shqetësimin e ngritur për çështjen e 52 shtëpive e kanë përcjellë te Kryetari. Gjithashtu, në emër të anëtarit të Komisionit të aksionarëve në ndërmarrjen "Trafiku Urban", tha se nuk ka pasur kërkesë në emër Drejtorisë së Trafikut dhe se letra e publikuar është pa emër dhe pa adresë.

Aziz Pacolli pyeti lidhur me mosrealizimin e linjave të propozuara për transportin e udhëtarëve lagja "Bregu i Diellit" - Gërmi dhe lagja "Kodra e Trimave" - Gërmi, linja të miratuar me vendim të Kuvendit. Pse këto vendime nuk janë përcjellë te ndërmarrja "Trafiku Urban". Ai kërkoi që këto propozime t'i drejtohen Komisionit të aksionarëve të Trafikut Urban.

Tefik Mehmeti tha se duhet pasur parasysh ndërtimin e rrugëve në zonat rurale, në veçanti ceku rrugën Viti - Bullaj.

Shemsi Veseli tha se për shqetësimet e ngritura në KPF, do të ishte mirë që 30 minuta para se të fillohet me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit, të analizohen dhe shqyrtohen këto shqetësime, që si anëtarë të Kuvendit kemi të drejtë t'i shprehim shqetësimet, kërkesat dhe t'ia imponojmë ekzekutivit që të na japë përgjigje.

Një dukuri, e cila është tejet shqetësuese, është edhe rreziku që iu kanoset qytetarëve nga qentë endacakë, sidomos te Parku memorial, te varri i ish-Presidenti Rugova, dhe përreth QKUK-së, ku ka shumë të tillë, prandaj është mirë që të merren masa, dhe duhet menduar se si ta gjejmë një formë veprimi për eliminimin e tyre.

Çështje tjetër që duhet veçuar janë edhe NPL-të, konkretisht raportet e tyre, të cilat po i miratojmë, e në fakt nuk po janë të singerta. Në këto ndërmarrje ka shumë probleme, por ne duhet të jemi të kujdesshëm për vendimet që i kemi marrë. Gjithashtu duhet të jemi tejet të kujdesshëm edhe për informatën kthyesë që ka të bëjë me Trafikun Urban. Ai kërkoi nga Komisioni i aksionarëve, të jetë më në nivel të detyrave dhe përgjegjësive që i ka.

Mbledhja mbaroi në orën 17:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

KRYESUESI I KOMITETIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.